

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7919
E enjte, 31 tetor 2024
Çmimi 0.50 €

Një gjurmues GPS vendoset në veturën e gazetarit Vehbi Kajtazi



FAQE 3

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



OPOZITA PËR RAPORTIN E PROGRESIT 2024: RAPORTI MË NEGATIV QË KA MARRË KOSOVA NDOJËHERË

FAQE 4-5



Komisioni Evropian ka publikuar raportet vjetore të progresit për vendet që synojnë anëtarësimin në BE. Raporti vjetor për Kosovën është vlerësuar nga

pushteti dhe është kritikuar nga opozita. Kjo e fundit ka theksuar se ky është raporti më negativ që ka marrë vendi ynë ndonjëherë, ku reflekton në masë të madhe

shturjen e sistemit qeverisës në Kosovë dhe largimin e vendit nga të gjitha proceset që e përafrojnë drejt Bashkimit Evropian

OPINION

ZGJEDHJET NË SHBA MË 5 NËNTOR 2024: NDIKIMI I TYRE NË PROCESIN ZGJEDHOR NË KOSOVË MË 9 SHKURT 2025 F. 6

Shkruan:
Prof. dr. Fejzulla BERISHA



AKTUALE



KE: KORRUPSIONI NË SHQIPËRI, PROBLEM SERIOZ F. 3

SHBA-ja SANKSIONON FIRMAT SERBE DHE MALAZEZE PËR SHKAK TË MBËSHTETJES TË LUFTËS SË RUSISË F. 2

EKONOMI



PËR FRYMË DHE ENERGJI STUDENTORE NË TREGUN E PUNËS F. 8

GUVERNATORI I SHQIPËRISË: BANKAT PO SULMOHEN VAZHDIMISHT F. 8

SPORT



DRITA ME FITORE BINDËSE NDAJ PRISHTINËS, FERIZAJ DHE MALISHEVA NDAJNË PIKËT F. 10

3.6 MILIARDË EURO BUXHET PËR VITIN 2025 F. 8



PSD-ja, AKSION PARA KUVENDIT TË KOSOVËS: 'NËN HETIM' F. 7

NËN HETIM Secili punëtor publik dhe familja e tij janë subjekte të hetimit nga Byroja e Partisë

RENOVA
PUTZ
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

ShBA-ja sanksionon firmat serbe dhe malazeze për shkak të mbështetjes të luftës së Rusisë

WASHINGTON, 31 TETOR - Shtetet e Bashkuara kanë vendosur sanksione ndaj kompanisë serbe "Ventrade" dhe ndaj International Business Corporation Bar (IBC), me bazë në Mal të Zi, për shkak të eksportimit të mallrave me përdorim të dyfishtë në Rusi, të cilat mund të përdoren në industrinë e mbrojtjes. Zyra amerikane për Kontrollin e Aseteve të Huaja (OFAC) tha përmes një deklarate se "Ventrade" i ka shitur Rusisë radio të kategorisë ushtarake, ndërkaq IBC ka transferuar pajisje të përpunimit dhe

kushineta të topave të kompanitë ruse, përfshirë të një kompani që është në sanksione amerikane. Sipas të dhënave të tregtisë të kompanisë "Ventrade", kompani e themeluar në prill të vitit 2022, pak pasi Rusia nisi pushtimin e Ukrainës, kjo firmë eksportoi radio në Rusi në vlerë prej 570 000 dollarësh. Këto eksporte ishin bërë në periudhën shtator 2022 deri në qershor 2023 përmes Gjermanisë, Malajzisë, Austrisë, Kinës dhe Meksikës. Që nga viti 2021 IBC është në pronësi të shtetasit rus me bazë në Mal të Zi, Sergei Kokorev, dhe

kjo kompani ka rritur fitimet më 2023 rreth 1 milion dollarë. Pesë firma të tjera serbe - MCI Trading, Kominvex, Goodforwarding, Soha Info dhe TR Industries - po ashtu veçse janë në sanksione nga OFAC për shkak të bashkëpunimit me Rusinë. Mali i Zi ka vendosur sanksione ndaj Rusisë, pasi Moska nisi pushtimin e Ukrainës në shkurt të vitit 2022. Ndërkaq Serbia, pavarësisht se është shtet kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, nuk u është bashkuar sanksioneve të bllokut evropian kundër Rusisë.



Zelensky e shkarkon prokurorin e Përgjithshëm



KIEV, 31 TETOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, e ka shkarkuar edhe zyrtarisht prokurorin e Përgjithshëm, Andriy Kostin, pasi hetimet zbuluan se shumë zyrtarë qeveritarë dyshohet se e shmangën shërbimin ushtarak duke pretenduar rrejtshëm se ishin me aftësi të kufizuara. Zelensky e nënshkroi të enjten dekretin për shkarkimin e tij, pasi Parlamenti i Ukrainës ka votuar në favor të shkarkimit të Kostinit dy ditë më parë. Kostin kishte thënë më herët se do të jepte dorëheqje për të marrë përgjegjësi politike, pas fillimit të hetimeve për korrupsion dhe për dyshimet se zyrtarët kishin

shfrytëzuar hendeqe ligjore për ta shmangur thirrjen në ushtri. Hetimet rishtazi gjetën se disa prokurorë publikë në rajonin perëndimor të Ukrainës, Hmelnitski, kishin nxjerrë dokumente në mënyrë të parregullt si persona me aftësi të kufizuara. Kjo ua kishte mundësuar atyre të merrnin përfitime të veçanta nga shteti dhe ta shmangnin shërbimin në ushtri njëkohësisht. Ky skandal ka nxitur kritika të mëdha në vend dhe thirrje për hetime në gjithë vendin, në një kohë kur Ukraina po ka vështirësi t'i zbrapsë forcat ruse, të cilat e nisën pushtimin e vendit në shkurt të vitit 2022.

Pas njoftimit të Kostinit për dorëheqje, kryeministri ukrainas Denys Shmyhal njoftoi se ka shkarkuar disa zyrtarë të lartë të përfshirë në këtë skandal. Çështja e thirrjes në ushtri është bërë e ndjeshme në Ukrainë, pasi ushtria ukrainase po përballet me sfida të mëdha, sidomos me pakësim të numrit të trupave si pasojë e luftimeve. Rekrutuesit ushtarakë shfaqen shpesh nëpër ngjarje publike për të vëzhguar nëse është duke u zbatuar ligji kontrovers për mobilizim. Zelensky e ka pranuar vazhdimisht se ushtria ukrainase përballet me rrethana "shumë, shumë të vështira".

Vazhdojnë kërkimet për të zhdukur në Spanjë pas përmbajtjeve vdekjeprurëse



VALENCIA, 31 TETOR - Autoritetet spanjolle lëshuan edhe një paralajmërim për stuhi të enjten për pjesën e rajonit të Valencias, ku një ditë më parë së paku 95 njerëz humbën jetën nga përmbajtjet shkatërruese. Ekipet e shpëtimit janë duke i vazhduar kërkimet të enjten për një numër të papërcaktuar të njerëzve të zhdukur në fushat dhe veturat e përmblytura. Autoritetet nuk kanë treguar se sa njerëz janë zhdukur, por ministrja e Mbrojtjes e Spanjës,

Margarita Robles, tha të mërkurën vonë se numri i të vdekurve do të rritet, sipas të gjitha gjasave. Moti i qetë u rikthye të enjten në pjesët më të goditura nga përmbajtjet më të mëdha në shekullin e fundit në Spanjë përreth qytetit të Valencias, por Instituti Meteorologjik i vendit, AEMET, e lëshoi alarmin e shkallës më të lartë për provincën Castellon. Meteorologët thanë se për tetë orë pareshtur ra shi sa për një vit

në pjesën e Valencias të martën, duke shkaktuar përmbajtje vdekjeprurëse. "Ka stuhi shumë të fuqishme në zonë, posaçërisht në veri të Castellonit. Moti i keq vazhdon! Kini kujdes!" paralajmëroi AEMET, duke i këshilluar njerëzit të mos udhëtojnë për në këtë pjesë të vendit. Përmbajtjet në Valencia shkatërruan infrastrukturën e rajonit, duke prishur ura, rrugë, hekurudha dhe ndërtesa, pasi lumenjtë dolën nga shtrati.

Sulmet raketore nga Libani vrasin pesë njerëz në veri të Izraelit

JERUSALEM, 31 TETOR - Pesë njerëz janë vrarë në jug të Izraelit të enjten si pasojë e raketave të hedhura nga territori i Libanit. Katër prej të vrarëve janë punëtorë të huaj, njoftuan autoritetet izraelite. Grupi militant Hezbollah ka kryer sulme me dronë dhe

raketa nga Libani në Izrael prej se Hamasi - grupi i shpallur terrorist nga ShBA dhe BE - e kreu një sulm në Izrael më 7 tetor 2023. Sulmi i Hamasit e nxitu luftën në Gazë. Hezbollahu, i cili e kontrollon Libanin jugor, është shpallur

organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, ndërsa Bashkimi Evropian e ka vendosur në listën e zezë krahu e tij të armatosur, por jo edhe partinë e tij politike. Hezbollahu dhe Hamasi janë aleatë të mbështetur nga Irani.



Një gjurmues GPS vendoset në veturën e gazetarit Vehbi Kajtazi

PRISHTINË, 31 TETOR - Një gjurmues GPS është gjetur të enjten në veturën e gazetarit Vehbi Kajtazi. Një video nga afër e pajisjes tregon se bëhet fjalë për një GPS që shërben për gjurmimin e veturave apo automjeteve të tjera. Gjurmuesi ishte vendosur me magnet në pjesën e jashtme të dyshemesë së veturës së gazetarit, në anën e majtë, në afërsi të rrotës, tregojnë pamjet.

Pajisja është një "Lighbug Pro", gjurmuesi ishte vendosur me magnet në pjesën e jashtme të dyshemesë së veturës së gazetarit, në anën e majtë, në afërsi të rrotës, tregojnë pamjet.

Rasti është hapur pranë Departamentit të Krimeve të Rënda në Policinë e Kosovës. Gjurmuesi u zbulua pas një kontrolli në veturën e drejtorit të "Paparaci"-t gjatë një kontrolli në një kompani servisi të veturave. "Sot kam sjell veturën në servis



për kontroll. Gjatë kontrollit është zbuluar se në veturën time është një pajisje e dyshimtë e vendosur në anën e majtë afër rrotës", tha Kajtazi.

Ish-deputeti i AAK-së, Daut Haradinaj, ka thënë se shteti nuk mbahet me persekutim dhe përgjim të gazetarëve apo pronarë të medieve që paguajnë taksa në

këtë Republikë. "Kushdo që ka vendos GPS në automjetin e gazetarit Vehbi Kajtazi, dëshmon qartë qëllimin negativ apo edhe kanosjen. Ky mjet përgjimi i

lëvizjes e ka bazën monitoruese diku, prandaj hetuesia duhet të vihet në lëvizje dhe ta zbardhë këtë rast sa më parë. Aferat nuk shihen me përgjues. Do t'ju dalin edhe të tjera shumë më të poshtra sesa ato që janë publikuar deri tash", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Gazetari, i cili para një jave deklaroi se dyshonte se po përgjohej ilegalisht nga Agjencia Kosovare e Inteligjencës (AKI), tha se për rastin e ka vënë në dijeni edhe Prokurorinë e Shtetit. "Për këtë rast është njoftuar edhe prokurori i shtetit", tha Kajtazi.

Të martën Kajtazi tha se ai dhe tre gazetarë të tjerë, Berat Buzhala, Ilir Mirena dhe Lirim Mehmetaj, ndodhen në vëzhgim të paligjshëm nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë. Kajtazi tha se këto veprime të pretenduara të AKI-së dëshmojnë për shndërrimin e agjencisë në "organizatë kriminale të pushtetit".

KE: Korrupsioni në Shqipëri, problem serioz

TIRANË, 31 TETOR - Shqipëria ka bërë pak përparim në luftën kundër korrupsionit falë punës së Prokurorisë së Posaçme, ndërsa për lirinë e medias nuk sheh asnjë përmirësim. Kështu tha ambasadori i delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë, Silvio Gonzato, i cili ia dorëzoi kryeministrit shqiptar, Edi Rama, Raportin e Progresit të hartuar nga Komisioni Evropian.

Gonzato tha se KE-ja vëren angazhimin e Shqipërisë për integrimin evropian si përparësi kryesore strategjike. Gjithashtu, sipas tij, KE-ja vlerëson harmonizimin e plotë me politikën e jashtme të BE-së. Ai tha se nëse hapi i reformave përshpejtohet, Shqipëria mund t'ia dalë t'i hapë të gjithë grupkapitujt deri në fund të vitit 2025.

Shqipëria ka hapur kapitullin e parë të negociatave për anëtarësim me Bashkimin

Evropian më 15 tetor.

Pasi renditi fushat ku Shqipëria ka bërë përparim, ambasadori u ndal te çështjet që shihen me shqetësim nga Komisioni Evropian. "Sa i përket kriterit politik, vlerësohet se funksionimi i institucioneve demokratike është pjesërisht i kënaqshëm, kryesisht për shkak të situatës thellësisht të polarizuar politike që ndikon negativisht në aftësinë e Parlamentit për ta luajtur rolin e vet dhe po rezulton edhe në vonesa për emërimin e individëve në poste kyçe", tha Gonzato.

Ai e cilësoi urgjente nevojën për të rindërtuar një dialog konstruktiv dhe gjithëpërfshirës politik, duke e vlerësuar si thelbësor për mundësinë për t'i realizuar reformat e lidhura me BE-në.

Korrupsioni mbetet sërish shqetësim serioz, përparimi që është shënuar vlerësohet se vjen falë punës së SPAK-ut, ndërsa ka shqetësim për politikën që



përpiqet të ndërhyjë. "Korrupsioni mbetet shqetësim serioz. Raporti vëren disa progres në luftën kundër korrupsionit dhe kjo ndodh për shkak të punës së shkëlqyer të SPAK-ut, i cili ka

vazhduar të prodhojë rezultate konkrete, përfshirë edhe për çështje ndaj politikanëve dhe zyrtarëve të nivelit të lartë. Edhe në luftën kundër krimit të organizuar, KE-ja sheh disa

progres, por edhe kjo falë punës së SPAK-ut. Shqetësimet mbeten sa iu përket orvatjeve për ndërhyrje dhe trysni politike në sistemin gjyqësor", tha ambasadori i BE-së.

Në QKUK 70 gra rikonstruktuan gjirin



PRISHTINË, 31 TETOR - Klinika e Kirurgjisë Plastike dhe Rekonstruktive e Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës ka shënuar përparim të madh sa i përket përkrahjes së grave që janë të diagnostikuara dhe trajtuara me kancer të gjirit.

Në këtë vit në këtë klinikë janë operuar 70 gra, duke bërë rikonstruktiv të gjirit, përmes operacionit, me përkrahje dhe nga Klinika e Anesteziologjisë dhe profilet e tjera infermiere që, po ashtu, kanë dhënë kontribut të çmuar.

Stafi mjekësor ka përdorur disa opsione për rikonstruksionin e gjirit, duke përfshirë përdorimin e

implanteve, transplantimin e indeve të vet pacientit (si përdorimi i indeve nga barku ose shpina), dhe kombinime të metodave.

Zgjedhja e teknikës varet nga nevojat dhe preferencat e pacientit, gjendja e indeve pas trajtimeve të mëparshme dhe faktorë të tjerë mjekësorë.

QKUK-ja ka njoftuar se përmes këtyre është arritur suksesi estetik dhe funksional, meqë përmes rikonstruksionit modern synohet të sigurohet një pamje natyrale dhe të ruhet ndjeshmëria e lëkurës sa më shumë të jetë e mundur. "Një rezultat estetik i kënaqshëm dhe simetria mes gjirit të

rikonstruktuar dhe gjirit natyral është një masë e rëndësishme e suksesit. Po ashtu, është arritur përmirësimi i cilësisë së jetës, meqë rikonstruksioni i gjirit mund të ndihmojë shumë gra t'i përballojnë më mirë pasojat psikologjike të mastektomisë (heqjes së gjirit), duke përmirësuar vetëbesimin dhe mirëqenien emocionale. Përparimet në teknikat kirurgjikale dhe kujdesin post-operativ kanë ulur shkallën e komplikimeve në mënyrë të ndjeshme. Pajisjet e nevojshme dhe materiali janë siguruar nga ana e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës", ka njoftuar QKUK-ja.



Opozita për Raportin e Progresit 2024: Raporti më negativ që ka marrë Kosova ndonjëherë

Komisioni Evropian ka publikuar raportet vjetore të progresit për vendet që synojnë anëtarësimin në BE. Raporti vjetor për Kosovën është vlerësuar nga pushteti dhe është kritikuar nga opozita. Kjo e fundit ka theksuar se ky është raporti më negativ që ka marrë vendi ynë ndonjëherë, ku reflekton në masë të madhe shthurjen e sistemit qeverisës në Kosovë dhe largimin e vendit nga të gjitha proceset që e përafrojnë drejt Bashkimit Evropian

propozuar heqjen e tyre. Raporti i Progresit tërheq vërejtjen se normalizimi i marrëdhënieve mbetet një kusht thelbësor në rrugën evropiane të të dyja vendeve dhe se ato rrezikojnë të humbasin mundësi të rëndësishme në mungesë të përparimit.

Kosova është e fundit në proceset integruese dhe e vetmja nga vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor që nuk e ka statusin e vendit kandidat, ndonëse kërkesën e ka dorëzuar në dhjetor të vitit 2022. Komisioni Evropian shpreh gatishmërinë që të përgatisë opinion për këtë kërkesë sapo që kjo të kërkohet nga Këshilli i BE-së.

Raporti njih përparimin e Kosovës në "luftën kundër krimit të organizuar, përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes si dhe liberalizimin e vizave" dhe kërkon shtimin e përpjekjeve "për ta forcuar sundimin e ligjit, administratën publike dhe për ta mbrojtur lirinë e shprehjes". "Qeveria duhet të punojë për të krijuar mbështetje politike ndërpartiake për të ndjekur në mënyrë më efektive reformat në lidhje me Bashkimin Evropian", thuhet në raport.

Kurti pranon Raportin e Progresit për Kosovën

Kryeministri Albin Kurti ka mirëpritur shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, ambasadorin Aivo Orav, nga i cili pranoi Raportin për Kosovën 2024 nga Komisioni Evropian, i cili, sipas njoftimit të qeverisë, vlerëson përparimin e Kosovës në rrugën drejt integritimit në Bashkimin Evropian.

Kryeministri falënderoi ambasadorin Orav për raportin dhe theksoi angazhimin e qeverisë për t'i çuar përpara reformat që janë thelbësore për anëtarësimin e Kosovës në BE. Në pikat e tij kryesore, Raporti i BE-së për Kosovën vlerëson pozitivisht liberalizimin e vizave si një hap që pritet ta përmirësojë lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës në Zonën Schengen. Ai vlerëson përkushtimin e Kosovës për përkushtimin me politikën e BE-së, nga ku veçohet linjëzimi me politikën e jashtme të BE-së një hap që reflekton angazhimin për bashkëpunim dhe integritet të plotë në familjen evropiane. Në raportin e këtij viti vlerësohet

angazhimi aktiv i Kosovës në zbatimin e Planit të Rritjes, agjendën e reformave si dhe angazhimin për promovimin e bashkëpunimit rajonal në zhbllokimin e vendimmarrjes në CEFTA me marrëveshje të reja që forcojnë tregtinë dhe lidhjet ekonomike brenda rajonit. Forcimi i kornizës ligjore në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar vlerësohen pozitivisht si prioritete të qeverisë për një shtet të drejtës. Reformat zgjedhore, sikurse edhe përmirësimi i kushteve të tregut të lirë dhe mbështetja për sipërmarrësit që ndihmon në rritjen e konkurrencës dhe tërheqjen e investimeve të huaja. Raporti vëren se nuk ka pasur asnjë ecje mbrapa në asnjërin nga fushat kyçe të reformës, ndërkohë që pothuajse në të gjitha fushat është shënuar progres – dëshmi kjo e përkushtimit të qeverisë për përparim dhe progres të vazhdueshëm.

Kryeministri mirëpriti rekomandimet e Bashkimit Evropian dhe theksoi se Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e angazhuar në rrugën e reformave.

Ndërkaq pas takimit të

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 31 TETOR - Komisioni Evropian ka publikuar raportet vjetore të progresit për vendet që synojnë anëtarësimin në BE. Në raportin vjetor të Komisionit Evropian për procesin e zgjerimit të bllokut, u kërkohet Kosovës dhe Serbisë zbatimimi i marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve që u arrit vitin e kaluar si dhe të të gjitha marrëveshjeve të kaluara, pa vonesa apo parakushte të mëtejshme.

Raporti kritikon, siç thuhet, veprimet e pabashkërenduara të Qeverisë së Kosovës në veri, duke vlerësuar se ato kanë dëmton marrëdhëniet e saj me komunitetin serb. Raporti

thekson se situata në veriun e Kosovës gjatë periudhës së raportimit është përshkruar me tensione të larta.

Kosova dhe Serbia duhet të angazhohen në mënyrë konstruktive për hapjen e urës kryesore mbi Ibër në Mitrovicë për lëvizjen e makinave, thuhet në raport, ndërsa theksohet se qëndrimi i Bashkimit Evropian mbetet i njëjtë. "Çdo vendim ose veprim për hapjen e saj duhet të merret dhe bashkërendohet në kuadër të dialogut dhe bashkë me partnerët e sigurisë", thuhet në raport.

Në raport thuhet se masat ndëshkuese të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës kanë mbetur në fuqi, ndonëse vihet re se shefi i politikës së Jashtme të bllokut, Josep Borrell, ka

Raporti i KE-së për Kosovën, AGK-ja: Ka përparim të kufizuar në lirinë e shprehjes

PRISHTINË, 31 TETOR - Komisioni Evropian të mërkurën ka publikuar Raportin e Progresit për vitin 2024. Te seksioni për lirinë e shprehjes, vlerësohet se Kosova ka bërë

“përparim të kufizuar” sa i përket lirisë së shprehjes. Raporti thekson zhvillime që kanë ndodhur në Kosovë e që janë perceptuar si përpjekje të qeverisë

për të ushtruar kontroll mbi mediet. Raporti i Progresit për këtë vit ngre shqetësimet për paqëndrueshmërinë

Transmetuesit Publik dhe dorëheqjet e shumta në mesin e drejtuesve dhe anëtarëve të lartë të Bordit, duke theksuar se transmetuesi publik duhet t'i

trajtojë me shpejtësi shqetësimet që lidhen me përgjegjshmërinë dhe pavarësinë editoriale.

Sa iu përket sulmeve kundër gazetarëve, Raporti i Progresit thekson se ende vazhdon të mbetet një nivel i pandëshkueshmërisë.

Në fund, Raporti i Progresit potencon se Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk janë zbatuar dhe mbeten të vlefshme.

Në vitin e ardhshëm Kosova, sipas rekomandimeve të Raportit të Progresit, duhet, në veçanti: ta përmirësojë kapacitetin e autoriteteve prokuroriale, gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit për t'i trajtuar rastet që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes; të zhvillojnë protokolle dhe trajnime për mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve, duke përfshirë mekanizmat e paralajmërimit të hershëm dhe të reagimit të shpejtë; përmirësimin e kushteve të punës së gazetarëve dhe punonjësve të medias; dhe ta forcojë raportimin profesional; ta sigurojë zbatimin e Ligjit të ri për Komisionin e Pavarur të Medieve duke siguruar harmonizim të plotë me acquis të BE-së dhe standardet evropiane; dhe rishikimi i Ligjit për Radio Televizionin e Kosovës për të siguruar financim të qëndrueshëm, duke ruajtur pavarësinë e saj.



Freedom of expression

Kosovo has some level of preparation and made limited progress. Some improvement was made on freedom of media, including access to public documents. However, this was coupled with developments perceived as attempts by the government to exercise control over the media.

A new law on the media regulator was adopted. It contributes to enhancing media regulation, but the Assembly's amendments failed to reflect most recommendations from the EU and other international partners. The functioning of the Independent Media Commission improved. The public broadcaster faced instability with a number of resignations among top management and board members. It needs to swiftly address concerns related to editorial accountability and independence. The media in Kosovo is pluralistic, but the sector still lacks transparency and financial sustainability. Data on the audiovisual market remains insufficient, including on media ownership and financing. Attacks against journalists are given due attention by the police and the judiciary, but some level of impunity remains, including because of the difficulty to investigate complex cases which occurred in the north. The environment in the north of Kosovo is restrictive and conducive to self-censorship for the public, the media and CSOs.

The Commission's recommendations from last year were not implemented and remain valid. In the coming year, Kosovo should, in particular:

- improve the capacity of the prosecutorial, judicial and law-enforcement authorities to handle cases related to the freedom of expression;
- develop protocols and training on the protection and safety of journalists, including early-warning and rapid-response mechanisms; improve the working conditions of journalists and media workers; and strengthen professional reporting;
- ensure implementation of the new Law on the Independent Media Commission by ensuring full alignment with the EU *acquis* and European standards; and review the Law on the Radio-TV of Kosovo to ensure sustainable funding, preserving its independence.

kryeministrit Kurti me shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë, Aivo Orav, u mbajt një konferencë e përbashkët për medie e zëvendëskryeministrit të Parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog të Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi dhe ambasadorit Orav, në të cilën u trajtuan të gjeturat e raportit si dhe arritjet dhe prioritetet e Republikës së Kosovës për të tashmen dhe të ardhmen.

Në adresimin e tij zëvendëskryeministri tha se: “Raporti i vendit për këtë vit tregon se qeveria ka vazhduar agjendën e saj ambicioze të reformave drejt Bashkimit Evropian. Në agjendën e integritimit evropian, Kosova është vlerësuar për prioritetimin politik që i është bërë këtij procesi si dhe janë theksuar arritjet në zbatimin e Agjendës së Reformave Evropiane ERA II dhe Programin Kombëtar për Integrim Evropian, ku në tri vitet e fundit kemi pasur një nivel të lartë të zbatimit tyre me mbi 70 %”.

Ai shtoi se Komisioni Evropian, po ashtu, përgëzojë Kosovën për përgatitjen dhe miratimin e Agjendës së Reformave në kuadër të Planit të Rritjes për vitet 2024-2027, e vlerësuar si një agjendë relevante, ambicioze, dhe që synon t'i përmbushë qëllimet e instrumentit të ri për

reforma dhe rritje ekonomike. Përmendi edhe të arriturat në kuadër të bllokut të kriterëve politike, atyre ekonomike, politikave sociale, sektoriale dhe agjenda e gjelbër. “Ne e mirëpresim vlerësimin e progresit nga Komisioni Evropian, por edhe më shumë i mirëpresim rekomandimet e këtij raporti të cilat do të merren seriozisht për periudhën e ardhshme. Implementimi i rekomandimeve nga raporti është i rëndësishëm për ne, jo vetëm në prizmin e progresit në integrim evropian, por edhe drejt zhvillimit të mëtejshëm të vendit tonë. Do ta vazhdojmë zbatimin e rekomandimeve, por edhe prioritetimin politik të agjendës së integritimit evropian, pavarësisht prej masave të padrejta që janë në fuqi”, tha zëvendëskryeministri, duke shtuar se Kosova tashmë i ka përmbushur të gjitha kërkesat dhe bazuar në rekomandimet e përfaqësuesit të lartë, Borrell, presim që Këshilli ta marrë një vendim të shpejtë për heqjen e tyre. “Kosova ka dëshmuar se është aleate e besueshme e Bashkimit Evropian dhe beson fort në të ardhmen e saj evropiane. Si shembull i demokracisë në rajon kemi treguar përkushtimin tonë sa herë që na është dhënë një mundësi e barabartë. Tani është

koha që edhe Bashkimi Evropian të tregojë se e sheh Kosovën si pjesë të saj, duke mbajtur procesin e integritimit meritokratik dhe duke avancuar Kosovën në status të kandidatit”, ka përmbyllur fjalën e tij Bislimi.

Opozita e quan raport negativ për Kosovën

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se raporti i Bashkimit Evropian për Kosovën për vitin 2024 është raporti më negativ që ka marrë vendi ynë ndonjëherë. “Mesazhet kryesore që dalin prej tij janë të qarta: Kosova mbetet nën sanksione! Kosova është duke u keq-qeverisur! Kosova është duke ecur prapa në të drejtat dhe liritë e njeriut, lirinë e shprehjes dhe të medieve, si dhe në drejtësi! Tri shtylla themelore mbi të cilat ndërtohet dhe funksionon shteti demokratik dhe zhvillimor, janë në stagnim apo regres. Tri fusha për të cilat është përgjegjëse e vetme Qeveria e Republikës së Kosovës, e për të cilat Partia Demokratike e Kosovës e ka ngritur zërin vazhdimisht gjatë këtyre katër viteve”, ka thënë Krasniqi.

Ai ka shtuar se, fatkeqësisht, dështimet e Qeverisë së Kosovës, të paraqitura në këtë raport, nuk janë vetëm pasojë e jokompetencës dhe paaftësisë së

tyre, por janë veprime të qëllimshme, të ndërmarra me vetëdije nga kryeministri dhe vartësit e tij, si mjete për ruajtjen e pushtetit. “Ky është një sabotim i zhvillimit dhe integritimit të vendit. Raporti është shqetësues dhe alarmues, e të cilit nuk i gëzohet askush, por i cili kërkon vëmendjen dhe reagimin e qytetarëve. Lajmi i vetëm i mirë në këtë mes është se 9 shkurti po afrohet, dhe me të, edhe fundi i kësaj qeverie. Qytetarët tanë, shteti ynë, meritojnë më mirë dhe më shumë. Meritojnë një qeveri të përgjegjshme, e cila do ta rikthejë Kosovën në drejtimin e duhur. Tjetër alternativë nuk ka!”, ka thënë Krasniqi.

Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se raporti i progresit, ashtu siç pritej, reflekton në masë të madhe shturjen e sistemit qeverisës në Kosovë dhe largimin e vendit nga të gjitha proceset që e përfaqësojnë drejt Bashkimit Evropian. “Kjo shfaqet në cenimin e demokracisë parlamentare, ndërhyrjet në media, sabotimin e sistemit të drejtësisë, defektet në prokurim, e pothuajse në çdo fushë të jetës. Në katër vitet e fundit Kurti e largoi dhe e sabotoi Kosovën nga proceset që e bëjnë anëtare të NATO-s. Me këtë raport shihet se e gjithë agjenda e tij është largimi i Kosovës nga të gjitha integritet euroatlantike.

Largimi i Kurtit nga qeverisja po shndërrohet çdo ditë në një obligim kombëtar për të gjithë ne”, ka theksuar Haradinaj.

Partia e Lumir Abdixhikut, LDK-ja, ka theksuar se Raporti i Progresit për vitin 2024 nga Komisioni Evropian nënvizon sfidat e vazhdueshme në Kosovë, mbi të gjitha thekson nevojën urgjente për ndryshim. “Raporti, gjithashtu, thekson qartë situatën ekonomike në Kosovë: ‘ritmi i rritjes është ngadalësuar krahasuar me vitet e mëparshme’. LDK-ja është e përkushtuar dhe do të punojë fort për ta rikthyer pavarësinë e medieve dhe për t'i mbrojtur institucionet demokratike nga ndërhyrjet politike. Ne do ta reformojmë gjyqësorin për të siguruar transparencë dhe përgjegjshmëri, si dhe do ta luftojmë korrupsionin me vendosmëri”, është thënë në reagimin e LDK-së, duke theksuar se këto janë rezultatet e paftësisë së qeverisë aktuale. “Fokusi ynë do të jetë për krijimin e vendeve të punës dhe krijimin e mundësive të reja në vend, në mënyrë që kosovarët të mos detyrohen të largohen.

Kosova meriton një qeveri që i përmbush premtimet e saj. LDK-ja do të udhëheqë pastër dhe me integritet. Është koha për ndryshim të vërtetë, tani!”, është bërë me dije në reagimin e LDK-së.

Zgjedhjet në ShBA më 5 nëntor 2024: Ndikimi i tyre në procesin zgjedhor në Kosovë më 9 shkurt 2025



Shkruan:
Prof. Dr. Fejzulla
BERISHA

Mbi qëndrimet dhe synimet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) ndaj zgjedhjeve të ardhshme në Kosovë më 9 shkurt 2025, ndriçon disa çështje kyçe politike dhe diplomatike. ShBA-ja vazhdon të mbështesë zhvillimin demokratik dhe institucional të Kosovës dhe ka interes të veçantë për të siguruar që ky proces të jetë gjithëpërfshirës, transparent dhe i monitoruar ndërkombëtarisht. Përvoja e saj e mëparshme për mbështetjen e zgjedhjeve në Kosovë, si më 2019 dhe 2021, ilustron theksin që ato vendosin mbi stabilitetin, përfshirjen etnike dhe shmangien e retorikës përçarëse, për ta ruajtur paqen dhe për ta forcuar shtetin e së drejtës.

Në këto zgjedhje ShBA-ja pritet ta

theksojë zbatimin e marrëveshjeve të rëndësishme si Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe, që është vendimtar për avancimin e dialogut Kosovë - Serbi. ShBA-ja synon, gjithashtu, t'i inkurajojë partitë politike që të fokusohen në reformat e brendshme për stabilitet dhe përmirësimin e ekonomisë, në mënyrë që të avancojnë qëllimet e integritimit euroatlantik të Kosovës.

Zgjedhjet e ardhshme presidenciale në ShBA, më 5 nëntor 2024, mund të ndikojnë në qasjen amerikane ndaj Kosovës. Dy kandidatët kryesorë, Kamala Harris dhe Donald Trump, përfaqësojnë qasje të ndryshme në politikën e jashtme: Harris pritet të vazhdojë mbështetjen ndërkombëtare për Kosovën, duke përfshirë përpjekjet për stabilitet dhe integritim euroatlantik, ndërsa Trumpi mund të adoptojë një qasje më të kufizuar, çka do të mund të ndikonte në mbështetjen amerikane për Kosovën në organizatat ndërkombëtare.

Nëse Kamala Harris ose Donald Trump zgjidhen president të ShBA-së, qëndrimi amerikan ndaj

Kosovës do të reflektojë dallimet në politikën e tyre të jashtme. Ja një analizë e të mirave dhe të metave të secilit kandidat për Kosovën:

Përparësitë për Kosovën: Harris, si pjesë e administratës Biden, përkrah fuqimisht aleancat ndërkombëtare si NATO dhe BE, që janë jetike për Kosovën. Ajo ka gjasa të vazhdojë përkrahjen e Kosovës në forumet ndërkombëtare dhe të përpiqet për njohje më të gjerë ndërkombëtare të Kosovës. Harris promovon përkushtimin ndaj Demokracisë dhe Sundimit të Ligjit, që njehet me e përkushtimin të thelluar ndaj vlerave demokratike dhe të drejtave të njeriut, gjë që përputhet me synimet e Kosovës për zhvillimin e institucioneve të forta demokratike. Harris pritet të mbështesë dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja, në përputhje me politikën e saj për stabilitet rajonal. Ajo mund të ndihmojë që ky dialog të vazhdojë në mënyrë konstruktive dhe të përpiqet të arrijë një zgjidhje afatgjatë.

Të metat për Kosovën: Harris do të fokusohet fillimisht në prioritetet e brendshme të ShBA-

së, siç është përforsimi i ekonomisë dhe politika e brendshme, gjë që mund të lërë më pak vëmendje për rajonin e Ballkanit. Meqenëse administrata e Harris-it mund të mbështesë më shumë BE-në si ndërmjetëse kryesore, Kosova mund të ketë nevojë për angazhim më të drejtpërdrejtë nga ShBA-ja, që mund të mungojë në disa raste. Të mirat e për Kosovën: Trumpi shpesh mbështet një qasje të drejtpërdrejtë dhe pragmatike. Nëse ai fokusohet në dialogun Kosovë - Serbi, mund të kërkojë rezultate të shpejta dhe të mbajë një presion mbi të dyja palët për arrijtjen e marrëveshjeve. Trumpi mund të ndërmarrë hapa të shpejtë për zgjidhjen e çështjeve ndërkombëtare, dhe kjo qasje mund të sjellë ndryshime të shpejta për çështje të rëndësishme si njohja ndërkombëtare e Kosovës.

Të metat për Kosovën: Trumpi shpesh mbështet një qasje më izoluese dhe mund të zvogëlojë përfshirjen amerikane në çështjet ndërkombëtare. Kjo mund të ndikojë në nivelin e mbështetjes për Kosovën në organizatat ndërkombëtare, duke reduktuar

ndihmën ose angazhimin e drejtpërdrejtë të ShBA-së.

Trumpi ka ndryshuar shpesh qëndrimin ndaj aleatëve ndërkombëtarë dhe mund të mos ofrojë mbështetjen e vazhdueshme që Kosova ka nevojë për stabilitetin e saj afatgjatë.

Si përfundim: Harris mund të sjellë një mbështetje më të vazhdueshme dhe multilaterale për Kosovën, Trumpi mund të fokusohet më shumë në zgjidhje të shpejta, por me një qasje më të kufizuar ndërkombëtare. Politikën e secilit do të ndikojnë jo vetëm në raportet me Kosovën, por edhe në ecurinë e saj drejt integritimit euroatlantik dhe stabilitetit të brendshëm.

Dialogu me ndërmjetësimin e BE-së dhe mbështetjen e ShBA-së mbetet vendimtar për stabilitetin rajonal dhe integritimin ndërkombëtar të Kosovës. ShBA-ja sheh zgjedhje të ardhshme në Kosovë si një mundësi për t'i përforcuar institucionet demokratike dhe për t'i avancuar qëllimet e vendit drejt integritimit euroatlantik, në përputhje me përkushtimin ndaj vlerave perëndimore dhe stabilitetit të qëndrueshëm.

Shqipëria krijon forcën e rezervistëve

TIRANË, 31 TETOR - Qeveria shqiptare i ka hapur rrugën krijimit të forcës së rezervistëve, pasi ka miratuar projektligjin që rregullon funksionimin dhe organizimin e një force të tillë.

Ministri i Mbrojtjes në Shqipëri, Pirro Vengu, tha për gazetarët se synohet që nga janari i vitit 2025 të nisët me hapat e parë për formimin e forcës së rezervistëve.

Përmes këtij projektligji Vengu tha se u japin mundësi ushtarakëve që kanë vendosur ta zhvillojnë karrierën në sektorin privat, që të angazhohen edhe në Forcat e Armatosura të Shqipërisë me misione specifike. Ai tha se në këto misione mund të përfshihen misionet paqeruajtëse në kuadër të angazhimit në NATO apo në rajon. "Në kuadër të detyrimeve dhe standardeve të NATO-s dhe sfidave të reja të sigurisë, ka lindur nevoja që ta konsiderojmë krijimin dhe organizimin e forcës së rezervistëve", tha Vengu.

Qeveria do të ndajë 15.5 milionë euro vitin e ardhshëm për këtë forcë, tha Vengu.

Shërbimi do të përfshijë një forcë rezerviste që do të përbëhet nga 25 për qind e forcave aktive, ose rreth 2 100 persona, duke siguruar kështu një kapacitet të rëndësishëm për reagim të shpejtë në raste emergjente.

Sipas përcaktimeve të projektligjit të ri, ushtarakët, të cilët, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij



ligji, kanë dalë në forcën rezervë, sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin për Karrierën Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si edhe shtetasit civilë, të cilët plotësojnë kriteret e pranimit të shërbimit ushtarak në rezervë, rekrutohen nëpërmjet procedurës së konkurrimit dhe nënshkruajnë kontratën përkatëse për shërbimin ushtarak në rezervë me kohëzgjatje jo më pak se dy vjet. Kjo kontratë më pas mund të

rinovohet. "Të gjitha vendet e NATO-s kanë forcë rezerviste dhe në këtë mënyrë kemi një instrument tjetër për ta bërë Forcën e Armatosur më tërheqëse dhe kjo u jep mundësinë të kenë gamë më të gjerë personeli në dispozicion. I konsiderojmë Forcat e Armatosura qoftë aktive, qoftë rezervë, si kapacitete kombëtare", tha ministri Vengu.

Më herët Qeveria e Shqipërisë ka miratuar rritjen e trajtimit financiar

për punonjësit e sektorit të mbrojtjes. Shtesa në pagë shkon deri në 700 euro. Ky vendim prek 6 000 punonjës të Forcave të Armatosura.

Shqipëria, po ashtu, do të rijetësojë së shpejti industrinë e vjetër ushtarake. Autoritetet kanë theksuar se rivënia në funksion e industrisë së vjetër ushtarake ka lindur si nevojë pas ndryshimeve gjeopolitike.

Me ndihmën e Agjencisë së

Prokurimit Publik të NATO-s është hartuar një raport mbi gjendjen e objekteve të industrisë ushtarake në Shqipëri. Në strategjinë e sigurisë kombëtare thuhet se synohet modernizimi i Forcave të Armatosura për t'iu përgjigjur sfidave të reja sigurisë.

Në korrik të këtij viti Këshilli Evropian kishte miratuar një paketë ndihme prej 13 milionë eurosh për ta mbështetur ushtrinë e Shqipërisë.

PSD-ja, aksion para Kuvendit të Kosovës: "Nën hetim"

PRISHTINË, 31 TETOR - Parti Socialdemokrate të premten ka mbajtur një aksion protestues. Në thumb të kritikës dhe kundërshtimit ishte "Byroja e Partisë". "Secili është i dyshuar përderisa nuk e provon pafajësinë, - kështu mund të formulohet përmbysja e prezumimit të pafajësisë. Në parim je i dyshuar, pastaj shohim. Nëse nuk dëmtohesh, shantazhohesh për t'u nënshtruar. Sot Kuvendi i Kosovës e ka në rend dite për

miratim njërin prej ligjeve që më së miri i dëshmon tendencat e pushtetit për kontroll dhe shantazh. Po na thonë se kështu po e luftojmë korrupsionin. Nëse qëllimi qenka lufta kundër korrupsionit, çfarë kuptimi ka shtrirja e fushëveprimit të ligjit te mësuesit, arsimtarët, mjekët, infermierët, deri te punëtorët teknik nëpër shkolla a institucione?!", është thënë në aksionin e PSD-së, duke shtuar se asnjë nga këto kategori nuk

menaxhojnë me fonde, me taksa të qytetarëve. "E vërteta është se lufta antikorruption po përdoret për t'i shtrirë tentakulat në mbarë strukturën shoqërore. Kjo Byro nuk është byroja për antikorruption, është Byroja e Partisë kundër lirisë së njerëzve. Ky ligj nuk duhet të kalojë, sepse liria do të triumfojë përkundër Partisë, përkundër linçimit e shantazhit", theksohet në aksionin e PSD-së.



ShBA-ja kritikon Serbinë për synimin që t'i gjykojë krimet në Kosovë

PRISHTINË, 31 TETOR - Departamenti Amerikan i Shtetit tha se pajtohet me Bashkimin Evropian se Serbia ka shkelur detyrimet nga dialogu i Brukselit, duke e miratuar Projektligjin për Juridiksion Gjyqësor në Kosovë dhe duke e shpallur Kosovën "zonë të mbrojtjes së veçantë sociale". "Ne përsërisim mbështetjen e qeverisë amerikane për integritetin territorial dhe sovranitetin e Kosovës në gjithë territorin e saj", tha një zëdhënës i DASH-it për Radion Evropa e Lirë.

Uashingtoni tha se dialogu për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, që ndërmjetësohet nga BE-ja, ka zhvilluar zgjidhje praktike që promovojnë të drejtat e qytetarëve të Kosovës, përfshirë serbët që jetojnë në veri të Kosovës. "Kjo duhet të zbatohet. Ne u bëjmë thirrje Kosovës dhe Serbisë që të zbatojnë, pa vonesa, zotimet që kanë bërë në Marrëveshjen e vitit 2023 për rrugën drejt normalizimit të raporteve, përfshirë themelimin e një asociacioni të komunave me shumicë serbe", tha zëdhënësi i DASH-it.

Një ditë më herët BE-ja kritikoi Serbinë për ligjin e miratuar më herët gjatë javës nga Serbia, që synon ndjekjen e veprave penale të kryera në territorin e Kosovës. Ligji që Qeveria e Serbisë ia propozoi Kuvendit serb për miratim më 28 tetor, parashihet gjykime për të gjitha krimet e parapara me Kodin Penal të këtij vendi, të cilat janë kryer pas



shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në shkurt të vitit 2008. Ky ligj u tha se do të zbatohet edhe për procedurat penale të nisura para miratimit të tij. Shefi i Zyrës për Kosovën në Qeverinë serbe, Petar Petkoviç,

tha se ligjet janë reagim ndaj, siç u shpreh ai, "shtypjes së popullit serb nga regjimi në Prishtinë dhe mungesës së veprimeve të dukshme nga misioni i BE-së, EULEX". Ai tha se "nëse do të kishte sundim të ligjit në Kosovë

dhe nëse serbët do të kishin ndonjë siguri juridike", atëherë ligji i propozuar nga qeveria në Beograd nuk do të ishte i nevojshëm". Edhe Kosova e ka kritikuar këtë legjislacion të Serbisë dhe

zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, e ka akuzuar Beogradin për shkelje të marrëveshjeve të dialogut dhe shkelje të sovranitetit dhe integritetit territorial me këto projektligje.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshjen për gjyqësorin në vitin 2015 dhe më 2017 dhe janë pajtuar për zbatimin e saj dhe integrimin e serbëve të Kosovës në institucionet e drejtësisë në Kosovë.

Por, qindra pjesëtarë të komunitetit serb në veri dhanë dorëheqje nga institucionet e Kosovës, përfshirë komunat, policinë, gjykatat dhe prokurorinë, në nëntor të vitit 2022, në shenjë pakënaqësie me disa vendime të Qeverisë së Kosovës.

Gjatë këtij viti Qeveria e Kosovës ndërmori disa hapa - si heqja e dinarit serb nga përdorimi dhe mbyllja e strukturave paralele serbe - në përpjekje për të shtrirë sa më shumë autoritetin e saj në veri.

Kjo e shtyri Beogradin zyrtar të njoftojë në shtator se do ta krijojë prokurorinë speciale për territorin e Kosovës, si një masë për mbrojtjen e "interesave jetike kombëtare të popullit serb" në Kosovë.

Ndërkaq, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka paraqitur më herët gjatë javës disa masa për Kosovën, duke thënë se Prokuroria Speciale dhe dhomat gjyqësore të veçanta do t'i "ndjekin të gjithë ata që marrin pjesë në persekutimin e popullsisë serbe" në Kosovë.

Miratohet lista përfundimtare me emrat e 24 prokurorëve të rinj të shtetit

PRISHTINË, 31 TETOR - Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti takimin e 256, në të cilin ka diskutuar pikat e rendit të ditës.

Këshilli i Prokurorial i Kosovës ka miratuar udhëzuesin për panelin vlerësues në zbatim të Rregullores 07/2024 për Emërimin e Kryeprokurorit të

Shtetit dhe Kryeprokurore të Prokurorive të Republikës së Kosovës, ka miratuar raportin e Komisionit për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit, të cilin e ka paraqitur kryetari i Komisionit rekrutues, kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj dhe, njëkohësisht, mori vendim që emrat e 24 prokurorëve të zgjedhur të

dërgohen për dekretim te presidentja e vendit, gjithashtu ka trajtuar kërkesën e një anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me rishikimin e pagës së tij dhe shtesave, si dhe autorizoi Komisionin për Çështje Normative që të përgatitë një analizë me rekomandime për këtë rast dhe rastet e tjera të ngjashme.



3.6 miliardë euro buxhet për vitin 2025

PRISHTINË, 31 TETOR - Qeveria e Kosovës ka miratuar projektbuxhetin për vitin 2025, që arrin vlerën prej 3.6 miliardë eurosh.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se kjo shifër përbën një rritje prej 9-përqindësh krahasuar me buxhetin e vitit paraprak. Ai tha se gjatë katër vjetëve të qeverisjes së partisë së tij, buxheti i Kosovës është rritur "vit pas viti si asnjëherë më parë".

Kurti tha se rritje të buxhetit ka për shumë sektorë, përfshirë atë të pagave, ku hyn rritja e paralajmëruar e pagave për sektorin publik.

Një ditë më parë ekzekutivi njoftoi se punëtorët e sektorit publik në

janarin e vitit të ardhshëm do të pranojnë paga me 55 euro rritje dhe 55 euro të tjera në korrik të vitit 2025.

Në mbledhjen e qeverisë të mbajtur më 30 tetor, Kurti tha se, përveç pagave, buxheti është rritur edhe për shtesat për fëmijë, 100 milionë euro janë shtuar për ta mbuluar rritjen prej 20-përqindësh të pensioneve, ndërsa sektorit të shëndetësisë i është shtuar buxheti për blerjen e barnave esenciale.

Ministri i Financave, Hekuran Murati, tha se buxheti është gjithëpërfshirës dhe reflekton trendin e rritjes ekonomike.

Murati tha se sektorët kryesorë që kanë përfituar rritje të buxhetit

janë sektori i mbrojtjes, i sigurisë, i shëndetësisë, i infrastrukturës rrugore e të tjera.

Ministri i Financave tha se sivjet Kosova ka pasur rritje të përshpejtuar ekonomike dhe në terma realë, kjo rritje në fund të vitit do të jetë 4.5 për qind.

Sipas mekanizmave ndërkombëtarë financiarë, rritja ekonomike e Kosovës këtë vit do të arrijë në afër 4 për qind.

Ndërkaq sa iu përket projeksioneve të qeverisë për rritjen ekonomike për vitin e ardhshëm, Murati tha se në Kosovë kjo rritje ekonomike do të jetë 5.6 për qind.

Sipas ligjeve, qeveria kishte afat deri në fund të tetorit që ta votojë



buxhetin për vitin e ardhshëm. Tani buxheti duhet të shkojë në Kuvend dhe të shqyrtohet e

miratohet nga deputetët, të cilët kanë afat deri në fund të vitit për miratimin e buxhetit.

Për frymë dhe energji studentore në tregun e punës

PRISHTINË, 31 TETOR - Në një konferencë të organizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ku u paraqitën gjetjet fillestare dhe hapat e ardhshëm për Fondin e Inovacionit të Kosovës, rektori i Universitetit të Prishtinës, Arben Hajrullahu, theksoi nevojën që ky fond të lidhë ekonominë, ndërmarrësinë, me punësimin e të rinjve dhe studentëve edhe më fort.

Në panelin diskutues "Zbërthimi i Rrugëtimit të Fondit të Inovacionit", rektori Hajrullahu tha se institucionet e shkollimit të lartë duhet t'i përshtatin programet e tyre mësimore me kërkesat e tregut të punës dhe teknologjitë e reja. Sipas Hajrullahut, Universiteti duhet të krijojë partneritete strategjike me sektorin privat dhe



ta nxisë inovacionin të studentët e ndërmarrësit si parakusht të zhvillimit të qëndrueshëm.

Panelin e moderoi Kujtim Dobruna nga ECIKS-i dhe bashkë me rektorin Hajrullahu diskutuan edhe dr. Sabine Mayer nga Departamenti i Strategjisë së Agjencisë Austriake për Promovimin e Kërkimeve (FFG), Brigit Tauber, drejtuese e Departamentit të Programeve të Përgjithshme (FFG) në të njëjtën agjenci, Anita Kovacic, drejtuese e Bordit Menaxhues të Raiffeisen Bankës në Kosovë. Pjesë e diskutimeve ishin edhe Zef Dedaj, ushtrues detyre i drejtorit të përgjithshëm në Agjencinë KIESA dhe Yllza Memeti, ushtruese detyre e udhëheqëses së Divizionit për Inovacion në Ministrinë e Arsimit.

Para se të nisnin diskutimet, të pranishmëve me fjalime iu drejtuan ambasadori i Austrisë në Kosovë, Georg Schnetzer, ministrja Rozeta Hajdari dhe drejtoreja rajonale e "CARE International", Sumka Bucan.

Konferenca u organizua me ndihmën e projektit austriak "Enabling Income Generation for the Poor" (EnInGeP), qëllimi kryesor i të cilit është zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit privat për të krijuar vende të punës dhe fitim të të ardhurave për të varfrit dhe të pambrojturit në Kosovë.

Projekti "EnInGeP" është financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), ndërsa zbatohet nga "CARE International" dhe kompania e këshillimit inovativ ECIKS.

Guvernatori i Shqipërisë: Bankat po sulmohen vazhdimisht

TIRANË, 31 TETOR - Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, tha se sulmet kibernetike ndaj sistemit bankar janë shtuar. Gjatë deklarimit para Komisionit Kundër Dezinformimit dhe Ndërhyrjeve të Huaja, ai shpjegoi natyrën e këtyre sulmeve dhe nga vijnë ato. "Sulmet janë të natyrave të ndryshme. Sulme që kanë të bëjnë me marrjen e të dhënave dhe me hakimin e llogarive bankare. Nuk mund të përcaktohet kollaj nga vijnë. Një ndër rastet që u konfirmua, u gjet që vinte nga Irani. Ka qenë një sulm i fortë kibernetik ndaj një banke që nuk ka cenuar llogaritë, por të dhënat. Është menaxhuar, por kemi nxjerrë mësim dhe na ka bërë të jemi në gatishmëri e të organizojmë më shumë punën kundër sulmeve kibernetike", tha Sejko.

Guvernatori tha se sulmet e vazhdueshme kanë nxjerrë si domosdoshmëri marrjen e disa masave për t'u mbrojtur nga këto

sulme. për këtë arsye është bashkëpunuar me Departamentin Amerikan të Thesarit. "Kemi marrë masa në vijimësi për mbrojtjen e sistemeve tona nga këto sulme, si në lidhje me sistemet informatike edhe të qarkullimit të pagesave. Me asistencën e Departamentit Amerikan të Thesarit kemi përgatitur një rregullore për mbrojtjen kundër sulmeve kibernetike. Rregullorja do të miratohet në mbledhjen e radhës të Këshillit Mbikëqyrës", theksoi Sejko gjatë raportimit para komisionit. Ai tha se rregullorja parashikon marrjen e masave të organizuara që të jenë standarde si për Bankën Qendrore edhe për ato të nivelit të dytë. Sejko, gjithashtu, theksoi se në 11 bankat janë bërë inspektime për sistemin e mbrojtjes dhe është bërë një vlerësim i masave që kanë ndërmarrë.

Më 2022 autoritetet shqiptare, por edhe ato ndërkombëtare kishin



akuzuar Iranin se qëndronte prapa sulmeve kibernetike të kryera në korrik ndaj infrastrukturës kritike qeveritare të

Shqipërisë. Tirana më pas ndërpreu raportet diplomatike me Teheranin dhe dëboi diplomatët iranianë nga Shqipëria.

Kryetari i Komisionit Kundër Dezinformimit dhe Ndërhyrjeve të Huaja, Erion Braçe, pyeti guvernatorin nëse ka ndërhyrje të huaja në institucionet financiare jobankare.

Guvernatori pranoi se ky sektor është zgjeruar, por se nga analiza që është bërë nuk ka rezultuar që ndonjë prej tyre të ketë pronarë përfitues me origjinë nga vende jomike me Shqipërinë. Disa medie patën shkruar se disa institucione të këtij sektori kishin origjinë ruse, por Sejko e konsideroi këtë si dezinformim.

Braçe e vuri theksin te një fenomen që u vërejt pas nisjes së luftës nga Rusia kundër Ukrainës më 2022, kur kompani të ndryshme u zhvendosën në vendet e Bashkimit Evropian. Ai tha se vendet në kufi me Rusinë e kanë shtuar vigjencën dhe kërkojnë që Banka e Shqipërisë të jetë në gatishmëri të lartë për të verifikuar raste të dyshimta.

Dikur të këqijtë e Holivudit ishin rusë ose kinezë, tani jemi ne – njerëzit nga Ballkani



Nga: Ana SCHNABL,
shkrimtare dhe kritike
slovene

Së fundmi pashë filmin e ri dedikuar audiencës mashkullore, *Wolfs*. Nëse mund të arsyetoj veten: isha e sëmurë dhe kisha mungesë të imagjinatës. Nuk më josh kombinimi Brad Pitt-George Clooney, as gjërat tipike “mashkullore” – vërtitjet me xhaketa lëkure, ngasja e makinave (me shpejtësi), batutat egomaniake kuazi-ironike. Sikur të mos ishte portretizimi i “shqiptarëve” dhe “kroatëve” dhe i mafieve të tyre rivale, mund të kisha rënë në gjumë.

Shqiptarët futen në film si një grup tipash të mëdhenj dhe me armë; mbarojnë shpejt, për më pak se një minutë. Kroatët, nga ana tjetër, paraqiten më hollësisht në një skenë më të gjatë të një dasme kroate.

Filmi është një realizim që lehtë harrohet; megjithatë, shfaq diçka po aq të vjetër sa vetë Holivudi dhe këtë nuk duhet neglizhuar. Pas shumë viteve të portretizimit “të të tjerëve” përmes amerikanëve autoktonë, afro-

amerikanëve, japonezëve, kinezëve, meksikanëve, rusëve dhe të tjerëve (me qëllim), Holivudi tani ka vendosur të shënjestrojë njerëzit e Ballkanit. Shqiptarët dhe kroatët janë zgjedhur sepse, për Holivudin, ata nuk janë të bardhë ose nuk janë mjaftueshëm të bardhë. Ajo që konsiderohet si “jo mjaftueshëm të bardhë” lidhet ose me historinë e kolonializmit ose me historinë e regjimeve komuniste; ndonjëherë, siç është rasti i shqiptarëve dhe kroatëve, historia e tyre përfshin të dy këto kushte. Besoj se, në Holivud, historia e Ballkanit kuptohet ashtu siç e kupton psikologu kanadez dhe mendimtari konservator, Jordan Peterson. Në një aktivitet në Lubjanë në vitin 2018, ai deklaroi se ishte hera e parë që mbante lëksion në një vend që dikur ishte “i izoluar prapa Perdes së Hekurt”. Përveçse ishte tërësisht e gabuar – Sllovenia nuk ishte asnjëherë prapa asaj që quhej Perdja e Hekurt – deklarata e Petersonit ishte simptomë e perceptimeve perëndimore për historinë e sistemeve komuniste dhe socialiste. Për Perëndimin dhe zërin e tij më të fuqishëm,

Holivudin, komunizmi dhe socializmi janë të barasvlershëm me Luftën e Ftohtë dhe me stalinizmin.

Historia e Jugosllavisë, e federatës së dikurshme së cilës i përkiste Sllovenia, rrallë kuptohet siç duhet. Jugosllavia ishte socialiste, por jo staliniste. Në fakt, Jugosllavia u shkëput nga sfera e ndikimit sovjetik në vitin 1948 dhe u bë një nga themelueset e Lëvizjes së të Painkuadruarve. Por, kjo nuk ka rëndësi për industrinë amerikane të filmit, pasi komunizmi dhe socializmi janë dy fenomene që ajo thjesht pëlqen t’i urrejë.

Kjo bazë ideologjike – dhe besimi perëndimor se ish-vendet komuniste janë të pushtuara nga kriminelët – e bëri të lehtë dhe logjike paraqitjen e shqiptarëve dhe kroatëve në *Wolfs* si të egër të paparashikueshëm dhe për këtë arsye si terroristë/armiq/keqbërës të rrezikshëm.

Megjithatë, diku gjatë gjysmës së filmit, etnitë e zgjedhura duhej të përkufizoheshin. Kështu, të gjitha paragjykimet e stisura për njerëzit nga Ballkani, të cilët kryesisht konsiderohen sllavë, u përfshinë

në skenarin, kostumet dhe ambientin e filmit. Në sytë e Holivudit, sllavët zakonisht shihen ose duke kërcyer në gjuhë ose duke vallëzuar në rreth, ose janë të dehur, të zhurmshëm apo melankolikë, pastaj agresivë në aspektin verbal ose fizik dhe, sigurisht, të korruptuar.

Për më tepër, në *Wolfs*, të “tjerët” paraqiten si njerëz të së kaluarës, njerëz me tradita të stisura. Prandaj, në dasmën e tyre do të ketë vetëm burra që vallëzojnë në rreth, ku babai do të jetë një patriark i vërtetë dhe nusja një grua e brishtë që ka nevojë për mbrojtje. Jam e kënaqur që asnjë nga të ftuarit e dasmës nuk valëviti flamurin kroat; të paktën shikuesit u kursyen nga paragjykimi se, mbi të gjitha, sllavët janë nacionalistë të thekur. Mos më keqkuptoni. Nuk ishte zemërimi që më shtyu të shihja filmin *Wolfs*, por ishte habia. Ky nuk është vetëm një produkt tipik i Holivudit, por gjithashtu një që tregon ashiqare se si funksionon në të vërtetë korrektësia politike neoliberale e Holivudit.

Industria amerikane e filmit ofron njohje dhe përfaqësim të padëmshëm vetëm për ato grupe

që kanë arritur – përmes aktivizmit politik ose social – të vendosen në hartën e saj perëndimore. Më pas, ajo ua shet këtë përfaqësim këtyre komuniteteve dhe mburret me përparimin dhe përfshirjen që bën. Nëse një komunitet – si shqiptarët, kroatët, slovenët ose maqedonasit – nuk kanë një zë të fortë në Perëndim, Holivudi mund të bëjë çfarë të dojë me të. Askush nuk do ta dëgjojë ankesën e këtij komuniteti të përshkruar gabimisht.

Korrektësia politike neoliberale nuk është shprehje e mendimit kritik, por shprehje e frikës nga humbja e reputacionit dhe nga largimi i audiencës, klientëve dhe votuesve. Është thjesht një transaksion, ndërsa për Holivudin ne njerëzit e Ballkanit nuk jemi pjesë e këtij transaksioni. Po të mos ishte aq e fuqishme antipropaganda e Holivudit, do të konsideroja se jemi me të vërtetë me fat. Në anën tjetër, ndoshta jemi me fat. Ndoshta sepse ende nuk i kemi hyrë Holivudit në zemër, ne mund ta shohim industrinë amerikane të filmit ashtu siç është në të vërtetë. //Telegrafi/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Qerimi zbulon listën për fazën e dytë kualifikuese për 'Euro 2026'

Prishtinë, 31 tetor - Javën e ardhshme Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve e fillon garën në fazën e dytë kualifikuese, përkatësisht në fazën kryesore kualifikuese për Kampionatin Evropian të vitit 2026.

Kombëtarja jonë është në grupin e gjashtë së bashku me

Holandën, Ishujt Faroe dhe Ukrainën. Grupi është sfidues, por Kombëtarja jonë e kërkon kualifikimin historik në Evropian. Ndeshjen e parë Kosova e ka në udhëtim ndaj Ishujve Faroe. Ndeshja zhvillohet në Torshavn më 6 nëntor nga ora 20:00. Më 10 nëntor nga ora 17:15 në Prishtinë është ndeshja Kosova - Holanda.

Selektori i Kosovës, Bujar Qerimi, të mërkurën ka shpallur listën e hendbollistëve në të cilët llogaritet për këto dy ndeshje. Qerimi ka ftuar 16 lojtarë. Emër i ri është Lionel Mirdita, që bën karrierë në Zvicër, ndërsa kthehen Drilon e Drenit Tahirukaj. Kosova të hënën udhëton për në Ishujt Faroe ku do t'i ketë katër seanca stërvitore

para ndeshjes. Dy të parët në grup kualifikohen në Evropian, ndërsa kualifikimin e sigurojnë edhe katër kombëtalet më të mira të pozitës së tretë prej tetë grupeve sa janë gjithsej.

Në Përfaqësuesja e Kosovës jemi të përkushtuar për fillim të mbarë dhe për hapin tutje në zhvillimin e vazhdueshëm.

Lista e hendbollistëve: K. Jupa, V.



Dedaj, K. Ninaj, A. Mushkolaj, L. Quni, D. Tahirukaj, L. Shabani, H. Berisha, B. Ramosaj, J. Muqolli, L. Gegaj, E. Gjuka, L. Mirdita, M. Taci, L. Zena, D. Tahirukaj.

Drita me fitore bindëse ndaj Prishtinës, Ferizaj dhe Malisheva ndajnë pikët

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 31 TETOR - Drita e ka deklasuar Prishtinën, pasi e ka mposhtur me rezultat bindës 3-0 në javën e 11-të në Albi Mall Superligën e Kosovës. Skuadra gjilanasë është kthyer te fitorja pas tri barazimeve radhazi. Në minutën e 22-të, Drita e shënoi golin e parë në ndeshje nëpërmjet Besnik Krasniqit, i cili u tregua i saktë nga penalltia për rezultatin 1-0. Dy minuta më vonë Albert Dabiqaj e shtoi epërsinë në 2-0. Në pjesën e dytë Prishtina u mundua të rikthehet në lojë, por pa sukses. Ndërsa vendasit e shënuan edhe golin e tretë në minutat e fundit, autor ishte Albert Dabiqaj që realizoi për 3-0. Me tri pikët e reja, Drita renditet në pozitën e dytë me 18 pikë, ndërsa Prishtina renditet e

pesta me 16 pikë. Ndeshja në mes të Ferizajt dhe Malishevës ka përfunduar me rezultat të barabartë 1-1. Në pjesën e parë nuk munguan rastet e shënimit, por gola nuk kishte. Në pjesën e dytë Ferizaj mbeti me një lojtar më pak në fushë, kur kapiteni i vendasve Edon Sadriu u ndëshkua me kartonin e dytë të verdhë dhe u përjashtua nga loja. Pasi kishin epërsinë numerike, Malisheva shtoi sulmet në ofensivë duke kërkuar golin e epërsisë. Në minutën e 92-të, Malisheva gjeti golin e parë me Drilon Hazrollajn që realizoi nga afërsia për 0-1. Mirëpo në minutën e shtatë shesë vendasit fituan një penallti pasi Arlind Veliu ndali në zonë Betim Haxhimusën. Nga penalltia, Albion Kurtaj u tregua i saktë për rezultatin 1-1. Ferizaj vazhdon të mbetet në pozitën e shtatë me 14



pikë, derisa Malisheva ndan pozitën e parë me 19 pikë me Ballkanin. Të mërkurën Dukagjini dhe Suhareka janë ndarë baras 2-

2 në një ndeshje spektakolare që u zhvillua në Klinë. Edhe ndeshja tjetër e zhvilluar në po të njëjtën ditë në mes të Llapit dhe

SUPERLIGA		
Drita - Prishtina	3-0	
Ferizaj - Malisheva	1-1	
Dukagjini - Suhareka	2-2	
Llapi - Feronikeli '74	2-2	
Ballkani-Gjilani	3-3	

TABELA		
		Pikë
1. Ballkani	11	19
2. Malisheva	11	19
3. Drita	9	18
4. Suhareka	10	17
5. Prishtina	10	16
6. Llapi	11	15
7. Ferizaj	11	14
8. Gjilani	11	13
9. Dukagjini	11	11
10. Feronikeli '74	11	3

Feronikelit '74 përfundoi me rezultat 2-2. Në këtë xhiro, Ballkani ka luajtur baras me Gjilanan (3-3).

Feronikeli '74 tërhiqet nga garat

"Epoka e re"

DRENAS, 31 TETOR - Skuadra e futbollit nga Drenasi, Feronikeli '74, është tërhequr edhe zyrtarisht nga garat. Kjo skuadër ka njoftuar tifozët "Tigrat e zi", simpatizantët, lojtarët, trajnerët, donatorët dhe qytetarët e Drenasit, se një gjë të tillë po e bën për shkak të ndarjes së drejtësisë gjithnjë, sipas tyre, në dem të "Niklit". "FC Feronikeli 74 ka vendosur të mos vazhdojë më garat në këto rrethana ku, sipas

nesh, referët po përcaktojnë rezultatin e ndeshjeve dhe jo loja në fushë. Prej kohësh kemi garuar me përkushtim dhe dinjitet, duke promovuar një futboll të pastër në Superligën e Kosovës. Pavarësisht prej pengesave dhe padrejtësive të shumta nga referët, besuam në zhvillimin 'fair-play' të sportit dhe në integritetin e FFK-së. Ky, ndoshta, ishte gabimi ynë më i madh. Sot, pas përpjekjeve të shumta për të kërkuar drejtësi, pohojmë qartë: 'Mjaft është mjaft!', thuhet në njoftimin e



Feronikelit. "Humbëm pikë, por kurrë nuk u ndjemë humbës në fushë. Për ne humbësi i vërtetë ishte referi kryesor, i cili i

shndërroi ndeshjet në një padrejtësi të rëndë. Përmes këtij vendimi publik njoftojmë tërheqjen përfundimtare nga të gjitha garat e Federatës së Futbollit të Kosovës. Ky vendim është marrë pas analizave të shumta dhe përpjekjeve tona për të sjellë drejtësi por, për fat të keq, kemi mbetur pa asnjë opsion tjetër. Nëse FFK e konsideron të drejtë këtë qasje, ne nuk mund të jemi më pjesë e një gare të tillë. E ftojme Prokurorinë t'i hetojë referët dhe sjelljet e tyre të njëanshme, të cilat kanë dëmтуar

sportin që të gjithë e duam. Kërkojmë falje të sigjerta për futbollistët tanë, për tifozët 'Tigrat e Zi', për donatorët dhe për të gjithë ata që kanë qëndruar përkrah nesh ndër vite", thuhet në njoftimin e skuadrës nga Drenasi.

Në njoftim bëhet me dije se në këto rrethana bordi, së bashku me presidentin, tërhiqen nga klubi. "Për të gjithë ne, Feronikeli 74 do të mbetet gjithmonë klubi i zemrës, por në një ligë që nuk i respekton parimet e drejtësisë, ne nuk do të gerojmë më".


Anulohet ndeshja Valencia - Real Madrid

Valencia, 31 tetor - Siç pritej, Federata Spanjolle e Futbollit (RFEF) ka njoftuar se të gjitha ndeshjet e planifikuara për këtë fundjavë në zonën e Valencias, përfshirë ndeshjen e Real Madridit në La Liga kundër

Valencias, janë shtyrë. Komuniteti Valencias është prekur rëndë nga stuhia "DANA" që ka shkakuar viktima dhe dëme të shumta materiale për shkak të përmblyjeve në rajon. Nisur nga situata, Valencia kishte kërkuar

nga La Liga shtyrjen e përbaljes kundër Real Madridit, me ligën që nga ana e tij ia përcjell kërkesën RFEF Federata Spanjolle ka konfirmuar se ndeshja, së bashku me disa të tjera që ishin planifikuar të luheshin në rajon

këtë fundjavë, nuk do të zhvillohen. Ndeshjet që janë shtyrë janë Villarreal vs Rayo Vallecano, Valencia vs Real Madrid, CD Castellon vs RC Ferrol, CD Eldense vs SD Huesca dhe Levante vs Malaga CF



Drejtori i Rubin Kazanit: Dakun nuk e shitëm pasi ofertat ishin të ulëta

KAZAN, 31 TETOR - Mirlind Daku ishte shumë pranë të ndryshonte skuadër në merkaton e verës, por në fund një gjë e tillë dështoi. Megjithatë, duke marrë parasysh formën e tij të mrekullueshme, Daku pritet të lëvizë në merkaton dimërore. Ka qenë drejtori sportiv i Rubin Kazanit, Konstantin Dzyuba, që

ka folur për mediet ruse për të ardhmen e sulmuesit shqiptar. Skuadra italiane Cagliari e kërkonte atë shumë, por kishte oferta të tjera nga klubet ruse, megjithatë Rubini refuzoi ofertat pasi ishin të ulëta. "Për Dakun ka pasur interesim si para Evropianit ashtu edhe pas tij. Ka pasur oferta zyrtare. Ne i kemi negociuar. Pas Evropianit,

interesimi për të është rritur ndjeshëm. Para së gjithash, aspekti financiar nuk na përshtatej, kështu që më tej negociatat nuk kishin kuptim", ka deklaruar drejtori sportiv i Rubinit. Drejtori sportiv nuk e ka përygjatur mundësinë e shitjes së Dakut gjatë vitit të ardhshëm. "Ne jemi në bisedime të vazhdueshme me

Mirlindin. Si çdo lojtar, ai ka motivin për t'u rritur. Ai ka ambicie, por ajo që më pëlqen tek ai është se ai ka vlerat e duhura. Në këtë fazë ai është i kënaqur me gjithçka në Rubin. Kur vjen koha për të ndryshuar diçka, do ta diskutojmë së bashku dhe do të marrim një vendim të përbashkët", ka deklaruar Dzyuba. Daku ka



shënuar gjashtë gola dhe ka kontribuar me tre asistime në 12 ndeshje për Rubin Kazanin gjatë këtij sezoni.

Behrami: Leao paguhet si kampion, por nuk është i tillë

MILANO, 31 TETOR - Te Milani vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes çështja e lënies në stol të Rafael Leaos në ndeshjen e madhe ndaj Napolit, të cilën kuqezinjët e humbën 2-0. Paulo Fonseca zgjodhi ta linte bashkëkombësin jashtë formacionit nismëtar dhe ta aktivizonte gjatë lojës, me ish-lojtarin e Sportingut dhe Lilles që u përpoq "ta minonte" mbrojtjen napolitane me disa inkursione të shpejta, të cilat vunë në alarm Di Lorenzon. Kapitani i Napolit mori masa më pas, duke shmangur reziqe të reja dhe neutralizuar kundërshtarin. Në orët në vijim të ndeshjes së vlefshme për javën e 10-të të Serisë A, shumë vazhdojnë të reflektojnë mbi vlerën e Rafael Leaos. Një temë që ndan opinionin publik sportiv në Itali. "Ai nuk është kampion". Kështu ka thënë në studiot e "DAZN" ish-mesfushori Valon Behrami, duke shpjeguar tezën e tij: "Ne duhet ta përcaktojmë saktë fjalën kampion. Leao nuk është i tillë për momentin. Ky është mendimi im. Ai pati një sezon të mrekullueshëm, duke fituar



titullin, por që atëherë nuk mund ta përcaktoj si kampion. Nuk mund ta shoh si të tillë përderisa nuk qëndron në skenën qendrore për shumë ndeshje radhazi. Ne e dimë se sa i mirë është ai në fushë të hapur, por duhet të ndalojmë së trajtuar Leao si kampion. Nëse trajneri e ul në stol, e ka një arsye. Le të rrijë në bankinë dhe kaq". Pastaj për pagën: "Ai paguhet si kampion? Epo, ky është problemi më i madh, që ndikon për keq edhe te lojtarët e tjerë". I pranishëm në studio, edhe Daniele Adani pranoi se ishte dakord me ish-mesfushorin e Zvicrës: "Vetë

Milani e bëri kampion me fjalë. Kampion të bën fusha e lojës, produkti që jep, sjellja e treguar. Leao është larg këtij statusi, referuar performancës së treguar prej tij". Këtë sezon Rafael Leao ka shënuar 1 gol dhe dhënë 4 asistime deri më tani, në 11 paraqitje mes Serisë A dhe Ligës së Kampionëve. Portugezi ka luajtur gjithmonë titullar në Evropë, ndërsa në Serinë A ka provuar jo pak edhe stolin. Pas humbjes 2-1 në Firence, portugezi regjistroi dy stola radhazi, shenjë e një hapi prapa në hierarkinë e Paulo Fonseca.

SHKURT

Sneijderi: Messi ma vodhi 'Topin e Artë' në vitin 2010

Ish-futbollisti holandez Wesley Sneijder ka thënë se e kishte merituar "Topin e Artë" në vitin 2010. Holandezi ishte mahnitës atë vit duke fituar të gjitha trofetë me Interin, por "Topin e Artë" e fitoi Messi. Në një intervistë së fundmi, ai është pyetur nëse Messi ia ka vjedhur "Topin e Artë" më 2010, për të cilën ka thënë haptas se e meritonte. "Po. Por, të jemi të sigurtë, jam më se i lumtur me faktin se në vitin 2024, 14 vjet më vonë njerëzit ende flasin. Shpesh më thonë 'Wes, të vodhën më 2010'. Po ta fitoja atëherë ndoshta do të thoshin 'E ka vjedhur'. Çmimet individuale janë të mira, por trofetë si Liga e Kampionëve janë më shumë të vlefshme për mua", ka thënë Sneijder.

Musiala dëshiron ta vazhdojë kontratën me Bayernin

Jamal Musiala ka vazhduar shkëlqimin me Bayern Munchenin këtë sezon, duke qenë vendimtar në fitoren 0-4 në udhëtim te Mainz në DFB Pokal. Mesfushori ofensiv është në bisedime me klubin për vazhdimin e kontratës dhe pas ndeshjes ndaj Mainzit ku realizoi het-trik e ka pranuar një gjë të tillë. "Po, mund ta imagjinoj qëndrimin këtu dhe kontratën e re. Jemi në bisedime. Unë jam i lumtur dhe po shijoj kohën time te Bayerni", ka deklaruar reprezentuesi gjerman. Drejtuesit e Bayernit prej kohësh janë në bisedime me agjentët e lojtarit për një kontratë të re, pasi duan ta blindojnë atë deri në vitin 2023. Reprezentuesi gjerman me kontratën e re pritet të kalojë edhe Harry Kanen në listën e pagave, me anglezin që fiton 25 milionë euro bruto në sezon. 21-vjeçari në 11 ndeshje këtë edicion ka shënuar shtatë gola dhe ka asistuar në katër të tjerë.

Guardiola pas eliminimit nga Carabao Cup: Jemi në vështirësi

Manchester City është eliminuar nga Carabao Cup, pasi është mposhtur nga Tottenham Hotspuri (2-1). Trajneri Pep Guardiola ka bërë rotacion në këtë ndeshje, por kjo i kushtoi me eliminim. Pas eliminimit strategu spanjoll e pranoi se City është në vështirësi. "Kishim vetëm 13 lojtarë në dispozicion, jemi me të vërtetë në vështirësi. Jemi në telashe. Në 9 vjet që kam këtu, kurrë nuk kemi qenë në një situatë të tillë, me kaq shumë dëmtime dhe mungesa", ka thënë Guardiola.

Real i synon transferimin e Rodrit

E përditshmja spanjolle "AS" bën me dije se Real i Madridit është i interesuar për ta blerë yllin e Manchester Cityt, Rodri. Fituesi i çmimit "Topi i Artë 2024" konsiderohet një figurë e rëndësishme, e cila mund të marrë frenat e repartit madrilen në dorë pas tërheqjes së Toni Kroosit. Edhe pse është ende herët të flitet për shifra, mësohet se klubi madrilen do të tentojë gjithçka për ta marrë Rodrin në "Bernabeu". Në këtë tratativë mund të ndikojë edhe situata në të cilën ndodhet skuadra e Cityt, e cila është në gjyq për shkak të bilanceve dhe sponsorizimeve të dyshimta. Nëse "qytetarët" do të dënohen, atëherë shanset për transferimin e Rodrit në Madrid shtohen ndjeshëm.

Bostoni pëson humbjen e parë sezonale, dy skuadra surprizë kryesojnë dy Konferencat

INDIANAPOLIS, 31 TETOR - Humbja e parë sezonale për Bostonin, që u mund me rezultat 135-132 pas kohës shtesë nga Indiana. Sfidë spektakolare, ku për Celticsin nuk mjaftuan 85 pikët e treshes Brown-Tatum-White. Për Indianan, shtatë lojtarë realizuan mbi 10 pikë. U dalluan Mathurin me 30 pikë e Siakam me 29 pikë. Zhgënjeu edhe ekipi i lakersave, që u mund me rezultat 134-110 nga Clevelandi, që kryeson i vetëm renditjen në Konferencën e Lindjes me pesë fitore. Mobley me 25 pikë e Mitchell me 24 bënë dallimin në fushë për Cavaliersin. Në Perëndim, kryeson ekipi i Oklahomës, që mundi me rezultat 105-93 San Antonion, duke korrur



fitoren e katërt radhazi (s'ka asnjë humbje). Fiton edhe skuadra e Golden State, që falë 21 pikëve të Hieldit mundi me rezultat 104-89 New Orleansin. Skuadra e clippersave humbet në sekondat e fundit me rezultat 106-105 në

fushën e saj nga Portlandi, sfidë ku u dallua Simonsi me 25 pikë për miqtë. Edhe Miami humbet në fushën e tij, 116-107 ndaj New York, ndeshje ku Towns realizoi 44 pikë e 13 rebounde.

REZULTATET

Charlotte - Toronto	138-133
Cleveland - Lakers	134-110
Indiana - Boston	135-132
Philadelphia - Detroit	95-105
Washington - Atlanta	133-120
Miami - New York	107-116
Chicago - Orlando	102-99
Memphis - Brooklyn	106-119
Oklahoma - San Antonio	105-93
Golden State - New Orleans	104-89
Clippers - Portland	105-106

Lautaro: Nuk ka më drejtësi për 'Topin e Artë', prisja renditje më të mirë

Lautaro Martinez u rikthye ta gjente golin dhe të ishte sërish vendimtar për skuadrën e Interit ashtu si në kohët e arta. Kapitani zikaltër dha një asistim dhe shënoi një gol duke qëndruar në

fushën e lojës për 90 minuta. Ai e ka vlerësuar Empolin si një nga ekipet më në formë të Italisë dhe nuk ishte aspak e lehtë. "Empoli është një skuadër me shëndet dhe shumë e vështirë për t'u

përballur. Është skuadër fizike dhe që luan shumë mirë në mesfushë, por ne e kishim përgatitur mirë, por pastaj me një lojtar më shumë në fushën e lojës ishte më e lehtë për ne", ka

thënë Lautaro. Një nga temat e diskutimit ishte edhe renditja e tij në "Topin e Artë" ku u pozicionua në vendin e shtatë. Ai bën ironi duke thënë se ka vend për përmirësim.

"Sinqerisht prisja që të renditesha pak më lart, por ndonjëherë këto çmime nuk vendosen në mënyrën e duhur dhe të drejtë në shumicën e rasteve", ka deklaruar Lautaro.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Germia Adventures" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812126432 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Germia Adventures" D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812126432 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Germia Adventures" L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 812126432 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Com Petroll" SH.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811403732 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Com Petroll" D.O.O. Gjakovë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811403732 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Com Petroll" L.L.C. with headquarters Gjakovë, has come to the decision to quit its business: 811403732 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Domenik Gjoka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X të sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Burim Brovina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Jetmir Malushi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12 dhe diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahar Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



RISHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Mbikëqyrës i lartë i Sigurimeve (një pozitë)
Grada e pozitës:	Pesë (5)
Pozita:	E përhershme
Departamenti:	Departamenti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve
Divizioni:	Divizioni i Mbikëqyrjes në Vend
I raporton:	Udhëheqësit të Mbikëqyrjes në Vend

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Kryen ekzaminime të vazhdueshme të kompanive të sigurimeve dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve;
- Udhëheq ekipën e ekzaminerëve në ekzaminimet në vend të siguruesve/ trajtuesve të dëmeve dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve;
- Bën planifikimin para ekzaminimit, duke përfshirë fushëveprimin e ekzaminimit dhe profilin e rrezikut të kompanisë;
- Kryen ekzaminime të fokusuar, për të adresuar fushat me probleme specifike;
- Kryen ekzaminimet në vend dhe rishikon raportet që dalin nga divizioni për raportim dhe analiza për nga saktësia, cilësia dhe përmbajtja e tyre;
- Kryen aktivitetet pas ekzaminimit duke përfshirë përpilimin e raportit të ekzaminimit me klasifikimet e caktuara të rrezikut dhe strategjitë mbikëqyrëse;
- Përpilon rekomandimet për masat që duhet të ndërmerren, bazuar në rezultatet e ekzaminimit;
- Rishikon raportet e ekzaminimit në terren për nga saktësia e ekzaminimit të realizuar, cilësia dhe përmbajtja e raportit.
- Bën përpilimin e letrës përcjellëse të raportit të ekzaminimit;
- Zhvillimin e masave përmirësuese – memorandumet të mirëkuptimit, marrëveshjeve, urdhrave duke përfshirë largimet dhe suspendimet etj.;
- Bën përcjelljen e zbatimit të masave përmirësuese;
- Ndihmon Udhëheqësin e divizionit të mbikëqyrjes në vend/ Drejtorin e mbikëqyrjes së sigurimeve në takime me siguruesit, apo të tjerë;
- Udhëzohet dhe trajnon mbikëqyrësit e sigurimeve që ka nën varësi, ashtu si udhëzohet nga Udhëheqësi i Divizionit të Mbikëqyrjes në Vend/ Drejtori i Departamentit të Sigurimeve;
- Kontribuon në planet e zhvillimit individual për inspektorët e sigurimeve dhe inspektorët fillestarë/juniorë të sigurimeve dhe certifikon përfundimin e planit të zhvillimit individual;
- Asiston në vlerësimin e performancës për mbikëqyrësit e sigurimeve dhe mbikëqyrësit e ri të sigurimeve;
- Rishikon/përpilon rregullat dhe rregulloret e reja të propozuara dhe identifikon çështjet/ndikimin;
- Ndjek zhvillimet në fushën e sigurimeve në nivel ndërkombëtar dhe bën propozime për ndryshime në kornizën ligjore të punës, në mënyrë që të rritet efikasiteti i mbikëqyrjes. (IAIS, IFRS 17, Solvenca I dhe II) etj.;
- Rekomandon ndryshime në procedurat/politikat e ekzaminimit;
- Siguron informata për raportin javor të mbikëqyrjes;
- Përmbush detyra të tjera të cilat i caktohen nga Udhëheqësi i Divizionit të Mbikëqyrjes në Vend/ Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve;

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Diplomë universitare në ekonomi, kontabilitet, financa, menaxhim, biznes, informatikë, matematikë;
- Të ketë përvojë pune profesionale në minimum 3 vite në fushën e menaxhimit të rreziqeve, auditim, financa, kontabilitet ose fusha të tjera të ngjashme që nder-lidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve;
- Përvoja në sigurime ose institucione të tjera financiare paraqet përparësi;
- Preferohen diploma dhe certifikata mbi përfundimin e kurseve dhe specializimeve të ndryshme në fushën e kontabilitetit (kontabilist i certifikuar), auditimit (auditor i jashtëm i certifikuar), certifikime në fushën e sigurimeve dhe rreziqeve;
- Aftësi të thella analitike në funksion të vlerësimit të rreziqeve dhe shëndetit të institucioneve financiare të mbikëqyrura;
- Njohuri domethënëse të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF) në funksion të vlerësimit të cilësisë së raportimit financiar dhe analizimit të pasqyrave financiare për qëllime mbikëqyrëse;
- Njohuri domethënëse të kornizës ligjore dhe rregullative, si dhe standardet e tjera të zbatueshme ndaj siguruesve, trajtuesve të dëmeve dhe ndërmjetësuesve për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre;
- Kërkohet aftësi e shquar e të kuptuarit dhe zbatimit të proceduarve dhe manualit të bazuar në rrezik gjatë ekzaminimit të institucioneve financiare;
- Përdor gjykim të drejtë dhe të logjikshëm për të realizuar praktika, objektiva dhe vendime të pavarura;
- Kërkohet të demonstroj aftësi domethënëse të komunikimit verbal, komunikimit me shkrim, hartimit të raporteve dhe prezantimit tek mbikëqyrësi, ekipi i ekzaminimit dhe palët e tjera;
- Aftësi shumë e madhe për të punuar në mënyrë efektive në grup me ekipin e ekzaminerëve; aftësi për menaxhimin e kohës lidhur me përfundimin cilësor të detyrave të deleguara;
- Njohje e mirë e Ms. Office;
- Preferohet të ketë njohje të mirë të gjuhës angleze;

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nositruara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **18 nëntor 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



PONOVNO OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Naziv radnog mesta:	Viši supervizor osiguranja (jedna pozicija)
Stepen pozicije:	Pet (5)
Pozicija:	Na neodređeno
Odeljenje:	Odeljenje za nadzor osiguranja
Odsek:	Odsek za nadzor na licu mesta
Izveštava:	Rukovodiocu nadzora na licu mesta

Pregled dužnosti i odgovornosti:

- Sprovodi stalne kontrole osiguravajućih društava i posrednika osiguranja;
- Vodi tim kontrolora u kontrolama na licu mesta osiguravača/rukovoaca štetama i posrednika osiguranja;
- Sprovodi planiranje pre kontrola, uključujući delokrug kontrola i profil rizika kompanije;
- Sprovodi fokusirane kontrole za rešavanje oblasti sa specifičnim problemima;
- Vrši kontrole na licu mesta i pregleda izveštaje koje izdaje odsek za izveštavanje i analizu za njihovu tačnost, kvalitet i sadržaj;
- Obavlja aktivnosti nakon kontrole uključujući pripremu izveštaja o kontroli sa zadatim klasifikacijama rizika i nadzornim strategijama;
- Sastavlja preporuke za mere koje treba preduzeti, na osnovu rezultata kontrole;
- Pregledava izveštaje o terenskim kontrolama u pogledu tačnosti obavljene kontrole, kvaliteta i sadržaja izveštaja.
- Sastavlja propratno pismo izveštaja o kontroli;
- Vrši izradu korektivnih mera – memorandum i razumevanju, sporazumi, nalozi uključujući smene i suspenzije, itd.;
- Prati sprovođenje korektivnih mera;
- Pomaže rukovodiocu Odseka za nadzor na licu mesta/direktoru nadzora osiguranja na sastancima sa osiguravačima ili drugima;
- Vodi i obučava supervizore osiguranja iz svoje nadležnosti, prema instrukcijama rukovodioca Odseka za nadzor na licu mesta/direktora Odeljenja za osiguranje;
- Doprinosi individualnim razvojnim planovima za inspektore osiguranja i mlade inspektore osiguranja i potvrđuje završetak individualnog razvojnog plana;
- Pomaže u proceni rada za supervizore osiguranja i mlade supervizore osiguranja;
- Pregleda/sastavlja nova predložena pravila i uredbes i identifikuje probleme/uticaj;
- Prati dešavanja u oblasti osiguranja na međunarodnom nivou i daje predloge za izmene zakonskog okvira rada, u cilju povećanja efikasnosti nadzora. (IAIS, MSFI 17, Solventnost I i II) itd.;
- Predlaže promene u procedurama/politikama kontrole;
- Pružna informacije za nedeljni izveštaj o nadzoru;
- Obavlja i druge poslove po nalogu rukovodioca Odseka za nadzor na licu mesta/direktora Odeljenja za nadzor osiguranja;

Potrebne kvalifikacije i iskustvo:

- Univerzitetska diploma ekonomije, računovodstva, finansija, menadžmenta, poslovanja, informatike, matematike;
- Da ima najmanje 3 godine profesionalnog radnog iskustva u oblasti upravljanja rizicima, revizije, finansija, računovodstva ili drugih sličnih oblasti koje se odnose na poslove i odgovornosti Odeljenja za nadzor osiguranja;
- Iskustvo u osiguranju ili drugim finansijskim institucijama je prednost;
- Poželjne su diplome i sertifikati o završenim različitim kursevima i specijalizacijama iz oblasti računovodstva (sertifikovani računovođa), revizije (sertifikovani eksterni revizor), sertifikati iz oblasti osiguranja i rizika;
- Duboke analitičke veštine u cilju procene rizika i zdravlja nadziranih finansijskih institucija;
- Suštinsko poznavanje međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja (MSFI) u cilju procene kvaliteta finansijskog izveštavanja i analize finansijskih izveštaja za nadzorne svrhe;
- Suštinsko poznavanje pravnog i regulatornog okvira i drugih standarda koji se primenjuju na osiguravače, rukovoace štete i posrednike za procenu njihove usklađenosti;
- Potrebna je izvanredna sposobnost razumevanja i primene procedura i priručnika zasnovanih na riziku prilikom kontrola finansijskih institucija;
- Koristi pravedno i logično prosuđivanje za realizaciju praksi, ciljeva i nezavisnih odluka;
- Potrebno je demonstriranje značajne verbalne komunikacije, pismene komunikacije, pisanja izveštaja i veština prezentacije supervizoru, kontrolnom timu i drugim stranama;
- Veoma jaka sposobnost za efikasan rad u grupi sa timom kontrolora; veštine upravljanja vremenom koje se odnose na kvalitativno izvršavanje delegiranih zadataka;
- Dobro poznavanje Ms. Office;
- Dobro poznavanje engleskog jezika je poželjno;

Svi kandidati moraju da dostave sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde od poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje pozicije koju ste imali i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata o zaštiti podataka o ličnosti);
- Izveštaj Fonda penzione štednje Kosova (Trust)** za relevantni period, ili poresku potvrdu Poreske administracije (PAK) kada se izveštaj Trusta ne primenjuje zakonski;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosova moraju biti zvanično priznate/nositrukovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak prijave:

- Zadnji rok za podnošenje prijave je **18 novembar 2024. godine**.
- Prijava se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik prijave neće biti razmatran.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti putem službene veb stranice: www.bqk-kos.org

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

